

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar kolegji, Shqipe Qerimi e Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Jeton Leci, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.A. nga Ferizaji, për shkak të veprës penale të shantazhit nga neni 341 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit L.A., av. V.M., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.919/2018, datë 19.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me datë 26.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit L.A., av. V.M., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.919/2018, të datës 19.07.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin, P.nr.919/2018, të datës 19.07.2018, të akuzuarin L.A. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të shantazhit nga neni 341 par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë dhe dënim me gjobë në shumë prej 500(pesëqind)€, të cilin i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej *1(një)muaji* pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. Në dënimin e shqiptuar do ti *llogaritet edhe koha e kaluar në* paraburgim nga data 21.06.2018 gjer me datë 19.07.2018. Nëse dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par.3. të KPRK-së, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20€, do të vuaj 1(një) ditë burgim. E dëmtuara K.V., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil. I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaje shumë prej 30(tridhjetë)€, si dhe konform nenit 39 par.3. pika.3.1, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumë prej 30(tridhjetë)€, brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit L.A., av. V.M., për të shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që ankesa e mbrojtësit të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet duke i kushtëzuar dënimin me burg në një afat sa më të gjatë të verifikimit.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së, për të cilën ishin të njoftuara me rregull të gjitha, mirëpo përkundër këtij fakti, në seancë nuk prezantoi asnjë nga ta dhe të njëjtit nuk arsyetuan mos ardhjen e tyre.

Prokuroria e Apelit me shkresën PPA/II.nr.950/18 datë 11.09.2018, ka propozuar që të refuzohet si a pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit L.A., av. V.M., aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, në fakt me ankesë as që ka mund të kontestohet ngase i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë dhe gjyqtari individual është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimi i kundërshtuar u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve te paraqitura ne ankesë.

Mbrojtësi i të akuzuarit sa i përket vendimit për dënim, me ankesë pretendon se Gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënim të rëndë ndaj të mbrojturit të tij në raport me veprën penale. Sipas ankesës, gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin e thellë e të sinqertë, kërkim faljen nga e dëmtuara si dhe rrethanën se i akuzuari me të dëmtuarën janë në një lidhje dashurie mbi 10 vite dhe se në asnjë mënyrë nuk ka pasur për qëllim dëmtimin e të dëmtuarës. Gjykata është dashur me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të vlerësojë edhe faktin se i akuzuari është prind i dy fëmijëve dhe mbajtës i familjes.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit, av. V.M., për një dënim më të butë, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 73 e 74 të KPRK-së, me ç'rast si rrethana lehtësuese ka vlerësuar se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, se është penduar, se është i moshës së re, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese, gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarin si dhe mënyrën e vrazhdë të të vepruarit të akuzuarit në raport me tani të dëmtuarën.

Vlerësimin e këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se në prani të këtyre rrethanave nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi më të butë, siç pa të drejtë pretendohet në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit.

Duke pasur parasysh se rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate në tërësi kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë, si dhe duke vlerësuar se tani e dëmtuara Kosovare në seancën e shqyrtimit fillesar ka deklaruar se me të akuzuarin më nuk ka asnjë raport dhe se për tri vite i akuzuari ia ka marrë përmes kërcënimeve rreth 50.000 €, se i njëjti i ka dalë përpara me thikë për ti kërkuar para, se e ka rrahë të njëjtën duke e kërcënuar se ka me vra, duke e diktë se e njëjta ka vetëm nënën dhe motra dhe duke vlerësuar edhe faktin se tani e dëmtuara i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, Kolegji penal i kësaj gjykate duke vlerësuar rrethanat lehtësuese në rastin konkret dhe atë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe duke marrë për bazë edhe mënyrën dhe rrethanat në të cilat janë është kryer vepra penale, vlerëson se dënimi i shqiptuar me burgim dhe gjobë, nga gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tyre dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
PA1.nr.944/18, me 26.10.2018

Bashkëpunëtori profesional
Jeton Leci

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
1. Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

2. Shqipe Qerimi

3. Ferit Osmani